

## AGJENCIA E SHËRBIMEVE TË NAVIGACIONIT AJROR



Autorial nga:  
**Alban Sylaj**

**Normalizimi  
i hapësirës së  
ulët ajrore të  
Kosovës**

**Njësia J3 AIR e  
KFOR ka qëndruar  
për vizitë në  
ASHNA**

**Mbahet Konferenca  
e 57 e IFATCA-së, për  
here të pare edhe  
Kosova  
pjesëmarrëse**

**ASHNA pjesë e puntor-  
isë për meteorlogji në  
Crocontrol**


**Mbahet trajnimi kërkim  
shpëtim në rast të  
fatkeqësive ajrore,  
pjesëmarrëse edhe  
Kosova**

**Revista prestigjioze “The  
Controller” artikull për  
Kontrollin e Trafikut Ajror të  
Kosovës**



**Menaxhmenti i ASHNA-së për vizitë në  
Hungarocontol**

**MARS, SHËNOHET  
RRITJE MBI 17% NË  
OPERIMET KOMERCIALE**



## Menaxhmenti i ASHNA-së për vizitë në Hungarocontrol



Menaxhmenti i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA), kanë qëndruar për një vizitë pune dy ditore tek Ofruesi i Shërbimeve të Navigacionit Ajror të Hungarisë, Hungarocontrol.

Menaxhmenti i ASHNA-së, i cili përbëhej nga Drejtori Bahri Nuredini, Menaxheri i Zyrës së Drejtorit Alban Sylaj si dhe Koordinatorja për Marrëdhënie me Jashtë Merita Makolli, u pritën nga Kryeshefi i Hungarocontrol, Kornel Szepessy, me bashkëpunëtorë.

Gjatë këtij takimi, i cili ishte përmbledhje e takimit të zhvilluar në ASHNA me datë 09 dhe 10 tetor 2017, U diskutua për shumë qështje të

rëndësishme për të dyja palët.

Temat në të cilat u vë theks i veçantë, ishin ajo për marrëveshjen aktuale që kemi me HungaroControl për ofrim të të dhënave radarike, ku dakorduam për ngritje të çmimit për ofrim të shërbimeve, e cila do hyj në fuqi pas përfundimit të procedurave administrative nga dy palët. Po ashtu u diskutua edhe Draft Marrëveshja për dhënie të shërbimeve të radiokomunikimit (Air Ground Communication Services - Radio Equipment). Ky draft është negociuar pothuajse një vit, ku tanimë u arrit marrëveshja që të fillohet shërbimi pas

përfundimit të procedurave administrative.

Ndërkaq ë fushën e trajnimeve, palët janë dakorduar që të fillohet shkëmbimi i të dhënave të nevojshme dhe takimeve të mëtutjeshme për trajnime potenciale për AIS dhe ATSEP.


Fushë tjetër bashkëpunimi që u arrit pajtueshmëri mes palëve, ishte edhe shkëmbimi i ekspertizës dhe ofrimit të shërbimeve të konsulencës, ku HungaroControl u zotua se në ato fusha ku ka kapacitete, do ofroi asistencë. Me këtë rast, me theks te veçantë u trajtua mundësia e bashkëpunimit në krijimin e dokumentacionit dhe

skemave përkatëse të kompetencës për ATSEP.

Edhe në fushën e planifikimit financiar, gjatë këtij takimi, menaxhmentit të ASHNA-së iu prezantua një program financiar i disenjuar nga HungaroControl, përmes të cilit bëhet planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve, përkatësisht edhe përcaktimi i tarifave për periudhat raportuese përkatëse. Menaxhmenti i HungaroControl u zotua se mund t na ofroj këtë program për nevojat tona.

Në fund të këtij takimi, palët u pajtuan për intensifikimin e bashkëpunimit në fusha të caktuara të cilat kanë interes të dyanshëm.

## OPERIMET KOMERCIALE JANAR—MARS, ME RRIJTJE MBI 13%



Operimet e menaxhuara Komerciale Janar \_Mars 2018

Gjatë muajit Mars 2018, në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, janë realizuar gjithsejtë 1151 Operime Komerciale, e që krahasuar me numrin e operimeve të realizuara gjatë periudhës së njëjtë të vitit

2017, saktësisht muajin Mars, ku janë realizuar 981 operime, kemi një rritje prej 17.3% apo 170 operime më shumë. Edhe në muajin Shkurt operimet në ASHNA kanë shënuar rritje mbi 10% ku janë

realizuar gjithsejtë 943 operime komerciale, e që krahasuar me numrin e operimeve të realizuara gjatë periudhës së njëjtë të vitit 2017, ku janë realizuar 864 operime. Po ashtu edhe muaji Janar ka shënuar rritje të operi-

meve me mbi 13%, ku janë realizuar gjithsejtë 1166 operime komerciale, e që krahasuar me numrin e operimeve të realizuara gjatë periudhës së njëjtë të vitit 2017, ku janë realizuar 1035 operime,

## DELEGACIONI I AMBASADËS SË SHBA-SË VIZITOI ASHNA-NË



Pamje nga vizita e Delegacionit të Ambasadës së SHBA-së në ASHNA

Një delegacion i Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, qëndroi për një vizitë në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA), me ç'rast u prit nga Menaxhmenti i ASHNA-së.

Delegacioni i Ambasadës së SHBA-së në Kosovë, i cili ishte në përbërje nga Zyrtaeri Ekonomik Matthew Briggs si dhe Dren Pozhegu Këshilltari

Ekonomik, u njoftua më për së afërmi me punën e ASHNA-së, sukseset dhe sfidat si dhe projektet zhvillimore. Fokus i këtij takimi ishin projektet e planifikuara në planin afatshkurtër dhe planin afatgjatë të realizimit nga ASHNA, me ç'rast, z. Mathew Briggs, përgëzoi menaxhmentin e ASHNA-së, për përkushtimin në sigurinë e ofrimit të shërbimeve të navigimit ajror.



## Njësia J3 AIR e KFOR ka qëndruar për vizitë në ASHNA



Menaxhmenti i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA), të Premtën datë 16.02.2018, priti një delegacionin të KFOR-it, i cili ishte për një takim pune në ASHNA. Pjesë e këtij delegacioni ishin, Shefi i J3 AIR të KFOR-it me bashkëpunëtorë.

Gjatë këtij takimi mes ASHNA-së dhe KFOR-it, përkatësisht njësisë J3 AIR-it, u diskutua për

implementimin e marrëveshjes së Procedurave për Operime të Përbashkëta, marrëveshje kjo e nënshkruar mes ASHNA-së dhe KFOR-it me datë 26 maj 2017.

Në fund të këtij takimi, palët u dakorduan që të vazhdohet ky nivel i bashkëpunimit mes ASHNA dhe KFOR, gjithmonë në të mirë të sigurisë së operimeve të navigimit ajror.



[Menaxheri i DMET gjatë prezantimit në Crocontrol](#)

## ASHNA pjesë e puntorisë për meteorologji në Crocontrol

Nga 22 deri më 24 Mars 2018, në Zagreb të Kroacisë, përkatësisht në ambientet e Ofruesit të shërbimeve të Navigacionit Ajror të Kroacisë "Crocontrol" është mbajtur Punëtoria mbi vlerësimin e kompetencës për personelin aeronautik meteorologjik, punëtori kjo e cila ishte vazhdimësi e punëtorisë mbajtur më 2016 po ashtu në Crocontrol - Zagreb.

Pjesë e kësaj punëtorie ishte edhe Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA) nëpërmjet Menaxherit të Departamentit

Meteorologjik z. Sherif Gosalci, ku në ditën e dytë të punëtorisë edhe u prezantuan të arriturat dhe sfidat e ASHNA-së, përkatësisht Departamentit Meteorologjik.



Meqë takimi kishte rastisur në ditën e dytë të jetë edhe dita botërore e meteorologjisë - 23 Mars, Crocontrol për

datën 24 Mars, kishte planifikuar një ekskursion në kështjellën e Trakoshqan-it dhe në mbrëmje me ceremoninë e shënimit të kësaj dite të rëndësishme për komunitetin nga meteorologjia aeronautike në Hotelin Antunoviq - Zagreb.

Pjesëmarrës në takimin pasues ishin Agjencitë nga: Kroacia, Sllovenia, Bosnjë dhe Hercegovina, Mali i Zi, Serbia, Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Bullgaria, Rumania, Hungaria, Sllovakia dhe Austria. Prezantimet e

pjesëmarrësve ishin të një rëndësie të veçantë ku u paraqitën përvojat dhe arritjet e vendeve të sipër përmendura në vendosjen dhe implementimin e procesit të vlerësimit të kompetencës që nga punëtorja e fundit mbajtur më 2016.

Gjatë këtij qëndrimi në Crocontrol janë realizuar takime me përfaqësuesit e vendeve pjesëmarrëse në takim që shpresojmë dhe besojmë që do të sjellin rezultate në rritjen e komunikimit dhe shkëmbimin përvojave nga fusha e meteorologjisë aeronautike.

## Normalizimi i hapësirës së ulët ajrore të Kosovës




**Autorial nga:**  
**Alban Sylaj**  
**Menaxher i Zyrës së Drejtorit**

Hapësira e ulët ajrore e Kosovës vazhdon të jetë jo e normalizuar, që do të thotë se ajo nuk mund të shfrytëzohet varësisht nga nevojat në 360 shkallë, por vetëm në rrugë ajrore të caktuara që nga përfundimi i Luftës në Kosovë në vitin 1999. Ky fakt është shumë domethënës dhe ka rrjedhoja të mëdha negative në rrjedhën e përgjithshme të trafikut ajror, sidomos atij civil e që për vendnisje/destinim ka Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari". Ka studime të shumta që janë bërë në lidhje me ndikimin negativ që ka kjo mungesë e normalizimit të hapësirës ajrore të ulët, ASHNA poashtu ka bërë një studim nga i cili dalin të dhëna që tregojnë se sa e vështirë është për Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" të jetë i konkurrues me aeroportet tjera në fqinjësi. Studimi i ASHNA-së ka krahasuar fluturimet nga aeroporti i Budapestit për në Prishtinë, përkatësisht në Shkup. Nga ky

studim ka rezultuar që me gjithë faktin që Prishtina është më afër gjeografikisht me Budapestin se sa Shkupi, 12.5% rrugë më e shkurtër, fluturimet aktuale që lidhin kryeqytetin e Hungarisë me atë të Kosovës rezultojnë të jenë 42% më të gjata në distancë të fluturuar se ato që për destinim kanë Shkupin. Sipas studimit të bërë nga ASHNA, rezulton që ky fakt të ketë shkaktuar shpenzime shumë të mëdha për fluturimet e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" dhe atë në masën prej 100 milion Euro për 18 vjetët e fundit, përkatësisht 1 milion CO2 të emituar më shumë se sa do të emitohej po të fluturoheshin rrugët optimale. Ndikimi financiar nuk merr parasysh shpenzimet për tarifën për mbifluturim dhe shpenzimet tjera, por vetëm shpenzimet shtesë për karburant. Pra, siç mund të shihet edhe nga harta ku janë paraqitur trajektoret reale të fluturuar nga aeroplanët, ndikimi i mungesës së normalizimit të hapësirës ajrore të ulët të Kosovës është shumë i madh dhe një nga arsyet pse Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari" është më i shtrenjtë për të

fluturuar nga ai se sa aeroportet në fqinjësi. Mungesa e normalizimit të hapësirës së ulët ajrore ka ndikim negativ edhe në të hyrat shtesë që ASHNA do të mund të kishte si rrjedhojë e ofritit të shërbimit të mbifluturimit për aeroplanët që për destinim/vend nisje kanë Aeroportin e Shkupit. Nga normalizimi i hapësirës ajrore të ulët të Kosovës do të përfitonte para së gjithash pasagjeri që shfrytëzon Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari", do të përfitonte, ASHNA përmes të hyrave shtesë, do të përfitonte Kosova përmes rritjes së numrit të gjithmbarshëm të

shfrytëzuesve të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari", do të përfitonin aeroportet në fqinjësi përmes trajektoreve direkte përmes hapësirës ajrore të Kosovës (Shkupi, Nishi, Podgorica, etj) por edhe do të ndotej ambienti shumë më pak përmes evitimit të emetimit të CO2 shtesë që ndodh sot. ASHNA mbetet e përkushtuar që të vazhdojë të kërkojë të bëhet normalizimi i hapësirës së ulët ajrore të Kosovës në të ardhmen e afërt, duke qenë se përfitimet do të ishin të mëdha për të gjithë nëse do të ndodhte një gjë e tillë.





## Mbahet Konferenca e 57 e IFATCA-së, për here të pare edhe Kosova pjesëmarrëse



Muajin e kaluar, përkatësisht mes 19.03.2018 dhe 23.03.2018 në Akra të Ganës u zhvillua konferenca e 57 e IFATCA-s (Federatës Ndërkombëtare të Shoqatave të Kontrollorëve të Trafikut Ajror).

encën e hapi kryetari i Ghanes Z. Nana Akufo-Addo.

Vitin e kaluar, përkatësisht në konferencën e 56-të vjetore të



ombëtare të Shoqatave të Kontrollorëve të Trafikut Ajror). Në këtë konferencë, për herë të parë si anëtar me të drejta të plota, mori pjesë edhe Kosova e përfaqësuar nga Kryetari i SINKON z. Artan Hasani. Konfer-

zhvilluar në Toronto - Kanada, Kosova është anëtarësuar në këtë organizëm ndërkombëtar të aviacionit civil. Është me rëndësi të ceket që IFATCA, krahas IFALPA-s dhe IFATSEA-s punojnë ngushtësisht

me ICAO-n, kështu që rëndësia e anëtarësimit të Kosovës në IFATCA është shumë e madhe në vazhden e anëtarësimeve të Kosovës në organizma ndërkombëtarë. Gjatë konferencës së 57-të të zhvilluar në Akra u diskutuan tema që kanë të bëjnë me çështje profesionale të kontrollorëve të trafikut ajror. Përfaqësues të ICAO, mbajtën mbledhje pune (ëorkshop) në lidhje me

shume tema te rëndësishme profesionale të KTA-ve. Si rrjedhojë e mungesës së fondeve, Kosova u përfaqësua nga vetëm një delegat, gjë që pamundësoi ndjekjen e punimeve në të tria grupet punuese që i zhvillonin sesionet njëkohësisht. Konferenca e radhës, e 58-ta më radhë, pritet që të zhvillohet në Kosta Rikë në vitin 2019.





## Mbahet trajnimi në kërkim shpëtim në rast të fatkeqësive ajrore, pjesëmarrëse edhe Kosova



**Search And Rescue - Basic Aeronautical SAR Course**  
26 - 28 February 2018, Rakitje, Croatia

Nga 26 shkurt deri më 02 mars 2018, në Rakitje, Zagreb, është mbajtur trajnimi në fushën e kërkim shpëtimit në rast të fatkeqësive ajrore, ku pjesë e këtij trajnimi ishte edhe Koordinatori për Kërkim Shpëtim në ASHNA, Afrim Aziri. Kursi 1: "Search and Rescue - Basic Aeronautical" dhe kursi 2: "Search and Rescue On-Scene Coordination Course". Përmbajtja e këtyre dy kurseve ka qenë si vijon:

- The origins of Search and Rescue: A brief history and the

- philosophy of Search and Rescue,
- International SAR conventions and laë,
- International SAR boundaries and areas of responsibility,
- SAR Manuals, National SAR plans, systems and procedures,
- Responsibilities and duties of a senior SAR manager,
- Operational control of SAR, Rescue coordination centers - ARCC,
- SAR satellites and radio distress beacons SAR agencies, facilities and assets,

- Aircraft ditching and ditching assistance From Initial search procedures to rescue planning for the future,
- Example of a SAR timeline.

Kjo përmbajtje e këtyre dy kurseve është në funksion të inkurajimit të kooperimit rajonal në lëminë e Kërkim - Shpëtimit mes shteteve të Evropës Jug-Lindore, duke promovuar planet kombëtare të Kërkim Shpëtimit, identifikimin e njësive apo agjencive që marrin pjesë në kërkim shpëtim dhe

rolin e tyre, këmbimin e informacioneve dhe eksperiencave të praktikuara në vende të ndryshme, si dhe harmonizimin e operacioneve në rast veprimit ndërkufitar mes shteteve, në mënyrë që misioni i kërkim shpëtimit të jetë sa më efikas dhe i standardizuar.

Objektiv i këtij trajnimi ishte po ashtu definimi dhe roli i agjencive të ndryshme që veprojnë në emergjenca civile nëpër shtete të ndryshme të rajonit ballkanik.



# REVISTA PRESTIGJIOZE “THE CONTROLLER” ARTIKULL PËR KONTROLLIN E TRAFIKUT AJROR TË KOSOVËS

➤ FOCUS ON KOSOVO

## FOCUS ON KOSOVO

BY PHILIPPE DOMOGALA, DEPUTY EDITOR

**NOTE and DISCLAIMER:** the controllers' association of Kosovo is the latest member association (MA) to join the IFATCA family having joined in Toronto in May 2017. This MA is a bit special as for the time being, not every country around the world recognises Kosovo as a state. IFATCA's EVP Europe visited Kosovo in September 2017 and talked to the local air traffic controllers, managers and the association on how IFATCA can help its members. I was invited in December 2017 to make a visit to Pristina for The Controller to report on the local situation from an ATC point of view. It should be clear that this article is not meant to be political, or to take any side in the diplomatic/political discussion. IFATCA is a professional organization and we are looking at the professional aspects and what affects ATC and aviation in general. I've attempted to report facts, as I saw them. If there are errors or inaccuracies in this article, they are mine alone.

A bit of late 20th century history to understand the present. Kosovo was part of Yugoslavia, a country that came into existence in 1918 after the first World War as a kingdom. During World War 2, the monarchy was abolished and in 1946, it was renamed the Socialist Federal People's Republic of Yugoslavia when a communist government was established. Its leader, Tito ruled and unified the country until his death in 1980.

Yugoslavia consisted of six socialist republics: Bosnia and Herzegovina, Croatia, Macedonia, Montenegro, Serbia and Slovenia. In 1974, two so-called Socialist Autonomous Provinces within Serbia, Vojvodina and Kosovo, were given equal status to the other members of the federation. Following the death of Tito on 4 May 1980, the federation faced rising ethnic nationalism. In the aftermath of the collapse of communism in Eastern Europe, inter-republic talks on transformation of the federation failed. This led to a series of ethnically-based wars and insurgencies between 1991 to 1999.

With Kosovo wanting to retain their independent status, one of those conflicts was the Kosovo war in 1998-1999. It ended in June 1999 with the occupation of Kosovo by NATO troops under UN resolution 1244. This mandated the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo (UNMIK) to ensure conditions for a peaceful and normal life for all inhabitants of Kosovo.

Kosovo unilaterally proclaimed independence in 2008 and adopted a new constitution. The European Union Rule of Law Mission in Kosovo (EULEK), which itself operates within the framework of Security Council Resolution 1244, assists and supports the Kosovo authorities in the rule of law area, specifically in the police, judiciary and customs areas. While the UNMIK still exists today, in September 2012, international supervision ended and Kosovo became responsible for its own governance.

### Present day situation

Despite largely self-governance, NATO still manages the entire Kosovo airspace and is likely to do so for the foreseeable future. The airspace was closed for overflights following the war, with only flights to/from Pristina allowed. Between 1999 and 2002, Pristina Airport air traffic control was done by military controllers (UK and Italy). In 2002, it was handed to members of the Icelandic Response Unit. In the meantime, 16 Kosovo ATCOs began training in different countries including Austria, Italy and Hungary. Those first Kosovar controllers took over from the Icelandic ones in 2004. Then ten more were recruited in 2005 and sent to Iceland for training. A 3rd generation was recruited in 2011 or 2012 and sent to Entry Point North in Sweden, for training. They were issued Icelandic civil licenses at the time, with the Icelandic mission ending in 2010.

Following the declaration of independence in 2008, a Civil Aviation Authority was established, which began issuing



Revista prestigjioze ndërkombëtare e Kontrollorëve të Trafikut Ajror “The Controller”, i ka kushtuar një artikull të gjatë Kosovës, përkatësisht Kontrollorëve të Trafikut Ajror të Agjencisë së

Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA), me titull “Focus on Kosovo”. Prestigjiozja “The Controller”, e cila është revistë e “International Federation of Air Traffic Controllers”

Associations” (IFATCA), me seli në Montreal të Kanadasë, në numrin e fundit të saj, botuar më 01 Shkurt 2018, trajtohet historia e Kosovës, që nga vitet e hershme të shekullit 20, saktësisht nga viti 1918 e deri në ditët e sotme. Vlen të theksohet se Kosova është anëtarësuar në IFATCA në vitin 2017.

Autori i këtij artikulli, Philippe Domogala, ishte për vizitë në ASHNA gjatë vitit 2017, me ç’rast u prit edhe nga Drejtori i ASHNA-së Bahri Nuredini, ku u informua më për së afërmi me të arriturat dhe sfidat e ASHNA-së.

“The Controller”, trajton në detaje historikun e Kontrollit të Trafikut Ajror, me theks të veçantë nga koha e pas luftës e më tej, ku ndër të arriturat, autori spikat shkollimin e kontrollorëve të trafikut ajror që nga viti 1999 e këtej, përmirësimin e kushteve të punës me kalimin në kullën e re si

dhe përmirësimin e kushteve të infrastrukturës. Si sfidë kryesore paraqitet mungesa e anëtarësimit të Kosovës në mekanizmat ndërkombëtare, siç janë ICAO dhe EUROCONTROL, si shkak i mungesës së anëtarësimit të Kosovës në OKB, si dhe normalizimi i hapësirës së ulët ajrore, veçanërisht pamundësisë së përdorimit të hapësirës ajrore të Serbisë, për fluturimet nga dhe për në Prishtinë.

Autori Domogala, gjatë realizimit të fluturimit të tij për në Prishtinë, ka qenë i akomoduar në kabinën e pilotit të fluturakes së Adria Airways, ku gjatë bashkëbisedimit me pilotin e kësaj kompanie, ky i fundit kishte shprehur kënaqësinë me profesionalizmin e Kontrollorëve të Trafikut Ajror të Kosovës dhe gatishmërinë e tyre që në çdo kohë të japin ndihmën e tyre.

## IMPRESSUM

Redaktor: Driton Ujkani

Kontribuan: Alban Sylaj; Sherif Gosalci; Afrim Aziri; Artan Hasani;

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror Vrellë, Lypjan, 10070, Republika e Kosovës  
Tel: +383 (0) 38 59 58 641  
E-mail: info.ashna@rks-gov.net  
web: www.ashna-ks.org

